

**EHW sh.p.k**

**Pasqyrat Financiare të konsoliduara më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022**

**Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur**

	<b>Faqe</b>
Raporti i Audituesit të Pavarur	<b>1-3</b>
<b>Pasqyrat Financiare të Konsoliduara</b>	
Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar	<b>4</b>
Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse	<b>5</b>
Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital	<b>6</b>
Pasqyra e konsoliduar e rrjedhjes së parasë	<b>7</b>
Shënime mbi pasqyrat financiare të konsoliduara	<b>8 - 35</b>

**Pasqyra e Konsoliduar e Pozicionit Financiar  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022**

	Shënime	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
<b>AKTIVE</b>			
<b>Aktivet afatgjata</b>			
Aktivet afatgjata materiale	6	1,368,843,306	1,137,490,970
Aktivet afatgjata jomateriale	7	22,601,014	19,869,569
Emri i mirë		1,414,403	1,414,403
Parapagime për aktive afatgjata materiale	8	421,204,858	182,957,343
Shpenzime të shtyra afatgjata	9	54,110,042	47,454,614
Pjesëmarrje në shoqëri të tjera	10	118,063,549	28,903,210
<b>Totali aktiveve afatgjata</b>		<b>1,986,237,172</b>	<b>1,418,090,109</b>
<b>Aktivet afatshkurtra</b>			
Inventari	11	677,221,374	496,359,623
Llogari të arkëtueshme tregtare	12	974,515,301	1,028,704,491
Llogari të arkëtueshme të tjera	13	67,563,455	37,277,475
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	14	194,565,095	205,609,572
Mjetet monetare në arkë e në bankë	15	1,737,570,924	1,406,109,942
<b>Totali aktiveve afatshkurtra</b>		<b>3,651,436,149</b>	<b>3,174,061,103</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>5,637,673,321</b>	<b>4,592,151,212</b>
<b>KAPITALI</b>			
Kapitali i nënshkruar		500,000,000	500,000,000
Kapitali i pakicës		68,141,988	68,141,988
Prime të lidhura me kapitalin		39,900,000	39,900,000
Rezerva ligjore		86,038,349	86,038,349
Fitime të mbartura		1,846,000,384	1,205,748,019
Fitimi i ushtrimit		773,100,029	740,252,365
Interesat e pakicës		505,495,490	290,025,704
<b>Totali kapitalit</b>	16	<b>3,818,676,240</b>	<b>2,930,106,425</b>
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrime afatgjata</b>			
Detyrime për qera financiare	17	272,734,590	52,128,916
<b>Totali detyrimeve afatgjata</b>		<b>272,734,590</b>	<b>52,128,916</b>
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Llogari të pagueshme tregtare	18	966,482,290	887,620,519
Detyrime tatimore	19	64,046,886	69,162,349
Detyrime ndaj punonjësve	20	29,177,185	22,894,198
Llogari të pagueshme të tjera	21	410,106,954	556,569,954
Detyrime për qera financiare	17	43,803,333	35,835,717
Parapagime të arkëtuara	22	32,645,843	37,833,134
<b>Total detyrime afatshkurtra</b>		<b>1,546,262,491</b>	<b>1,609,915,871</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>1,818,997,081</b>	<b>1,662,044,787</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>5,637,673,321</b>	<b>4,592,151,212</b>

Shënimet shpjeguese të faqeve 8- 35 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

**Pasqyra e Konsoliduar e Fitimit ose Humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	23	7,501,447,052	6,575,142,937
Të ardhura të tjera	24	43,629,993	5,250,359
<b>Total të ardhura</b>		<b>7,545,077,045</b>	<b>6,580,393,296</b>
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	26	(5,147,641,893)	(4,522,262,406)
Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces	27	(7,646,114)	4,611,641
Shpenzime personeli	28	(465,264,590)	(362,664,875)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	29	(193,083,043)	(180,876,665)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	30	(510,639,969)	(427,246,514)
<b>Total shpenzime</b>		<b>(6,324,275,609)</b>	<b>(5,488,438,819)</b>
Të ardhura nga pjesëmarrje	25	(7,799,383)	(13,506,797)
Të ardhurat/(shpenzime) nga interesat neto	31	(15,015,047)	(5,323,705)
Të ardhura/(shpenzime) financiare të tjera neto	32	(37,251,152)	545,070
<b>Total shpenzime financiare</b>		<b>(60,065,582)</b>	<b>(18,285,432)</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>1,160,735,854</b>	<b>1,073,669,046</b>
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	33	(171,989,821)	(168,243,105)
Shpenzime tatim fitimi i shtyre		(176,218)	(398,185)
<b>Fitimi i vitit</b>		<b>988,569,815</b>	<b>905,027,756</b>
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin:		-	-
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin</b>		<b>988,569,815</b>	<b>905,027,756</b>
<b>Qe i atribuohet:</b>			
Kompanise mëmë		773,100,029	740,252,365
Interesave jo-kontrolluese		215,469,786	164,775,391

Shënimet shpjeguese të faqeve 8- 35 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

**EHW sh.p.k**

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Konsoliduar e Ndryshimeve në Kapital  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022**

	Kapitali nënshkruar	Prime të lidhura me kapitalin	Rezerva ligjore	Fitime të mbartura	Fitimi i vitit	Totali	Interesat jo kontrolluese	Totali
<b>Pozicioni financiar më 1 janar 2021</b>	<b>500,000,000</b>	<b>39,900,000</b>	<b>86,038,349</b>	<b>919,445,873</b>	<b>543,302,146</b>	<b>2,088,686,368</b>	<b>276,417,301</b>	<b>2,365,103,669</b>
Transferim në fitime të mbartura	-	-	-	543,302,146	(543,302,146)	-	-	-
Fitimi i vitit	-	-	-	-	740,252,365	740,252,365	164,775,391	905,027,756
Dividendë të paguar	-	-	-	(257,000,000)	-	(257,000,000)	(83,025,000)	(340,025,000)
Transferim në rezerva ligjore	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2021</b>	<b>500,000,000</b>	<b>39,900,000</b>	<b>86,038,349</b>	<b>1,205,748,019</b>	<b>740,252,365</b>	<b>2,571,938,733</b>	<b>358,167,692</b>	<b>2,930,106,425</b>
Transferim në fitime të mbartura	-	-	-	740,252,365	(740,252,365)	-	-	-
Fitimi i vitit	-	-	-	-	773,100,029	773,100,029	215,469,786	988,569,815
Dividendë të paguar	-	-	-	(100,000,000)	-	(100,000,000)	-	(100,000,000)
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2022</b>	<b>500,000,000</b>	<b>39,900,000</b>	<b>86,038,349</b>	<b>1,846,000,384</b>	<b>773,100,029</b>	<b>3,245,038,762</b>	<b>573,637,478</b>	<b>3,818,676,240</b>

Shënimet shpjeguese të faqeve 8- 35 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Këto pasqyra financiare të konsoliduara janë aprovuar nga Bordi Drejtues më \_\_\_\_\_ korrik 2023 dhe janë nënshkruar për publikim në emër të tyre nga:

**Z. Mërkur Leka**  
Administrator



**Përgatitur nga:**  
**Znj. Arvena Selfo**

**Pasqyra e Konsoliduar e rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022**

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
<b>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</b>		
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>1,160,735,854</b>	<b>1,073,669,046</b>
<i>Axhustime për zërat jo-monetare:</i>		
Amortizimi	179,585,943	148,874,126
Zhvlerësimi	10,586,098	24,839,875
Nxjerrja jashtë përdorimit e mjeteve fikse,neto nga fitimi i kapitalit	7,871,813	2,045,601
Rezultati neto nga shitja e Aktiveve Afatgjata Materiale	(729,977)	8,531
<b>Fitimi operativ përpara ndryshimeve në kapitalin qarkullues</b>	<b>1,358,049,731</b>	<b>1,249,437,179</b>
<i>Ndryshimi në kapitalin qarkullues</i>		
Ndryshimi në inventar (rritje-/renie+)	(180,861,751)	1,403,131
Ndryshimi në llogari të arketueshme dhe të tjera (rritje-/renie+)	13,317,112	(626,630,014)
Ndryshimi në llogari të pagueshme dhe të tjera (rritje+/renie-)	(77,903,983)	434,166,340
Ndryshimi në parapagime e shpenzime të shtyra (rritje-/renie+)	4,389,049	(144,575,554)
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	6,282,987	2,182,098
<b>Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative</b>	<b>1,123,273,145</b>	<b>915,983,180</b>
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit	(172,166,039)	(163,055,435)
	<b>(172,166,039)</b>	<b>(163,055,435)</b>
<b>Aktivitetet investuese</b>		
Blerje të aktiveve afatgjata materiale	(114,897,376)	(188,492,742)
Blerje të AAJM	(6,366,734)	(12,086,718)
Parapagim për blerje AAM	(238,247,515)	(1,662,971)
Investime në pjesëmarrje	(89,160,339)	(16,934,730)
Shitje të aktiveve afatgjata materiale	2,636,835	541,722
<b>Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues</b>	<b>(446,035,129)</b>	<b>(218,635,439)</b>
<b>Aktivitetet financuese</b>		
Shtesa/pakësime në qera financiare	(73,610,995)	(41,999,326)
Dividendë paguar	(100,000,000)	(340,025,000)
<b>Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues</b>	<b>(173,610,995)</b>	<b>(382,024,326)</b>
<b>Ndryshimi neto i mjeteve monetare</b>	<b>331,460,982</b>	<b>152,267,980</b>
Mjetet monetare në fillim të periudhës	1,406,109,942	1,253,841,962
<b>Mjetet monetare në fund të periudhës</b>	<b>1,737,570,924</b>	<b>1,406,109,942</b>

15

Shënimet shpjeguese të faqeve 8 - 35 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

## **1. Informacion i përgjithshëm**

EHW sh.p.k. ("Shoqeria") është krijuar më 04.11.1992 me vendim gjykate Nr. 9185 datë 04.11.1992. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe nga statuti i saj.

Aktiviteti kryesor i shoqërisë është ndërtim i linjave industriale për përpunimin e mishit dhe prodhimin e sallameve si dhe tregëtimin e këtyre produkteve.

Përfaqësues Ligjor i shoqërisë është z.Mërkur LEKA.

Pasqyrat financiare janë paraqitur të konsoliduara për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2022 duke përfshirë edhe shoqëritë e zotëruara: 100% "Qafshatama" sh.p.k dhe 55% "Conad Albania" sh.p.k.

Investime të tjera ku njësia zotëron 50% të kuotave të kapitalit paraqitur bazuar në metodën e kapitalit është shoqëri EM-21 sh.p.k .

Veprimtaria kryesore e shoqërisë "Qafshatama" sh.p.k. është prodhimi dhe ambalazhimi i ujit në burim apo në vende të tjera.

Shoqëria "Conad Albania" sh.p.k operon në fushën e blerjes, dhënies me qira, shitjes së aktiviteteve tregtare me shumicë dhe pakicë dhe të veprave që kanë lidhje me këto aktivitete, si dhe import-eksport të mallrave të ndryshëm që do të jenë objekt i aktivitetit tregtar.

Kompania EHW sh.p.k është rregjistruar në Drejtorinë Rajonale të Tatim Paguesve të Mëdhenj Tiranë me NIPT: J61804031V. Kompania "Qafshatama" sh.p.k është rregjistruar në Drejtorinë Rajonale të Tatim Paguesve të Mëdhenj Tiranë me NIPT: K63910203U. Kompania "Conad Albania" sh.p.k është rregjistruar në Drejtorinë Rajonale të Tatim Paguesve të Mëdhenj Tiranë me NIPT: L21423017V

Selia e shoqërisë ndodhet në autostradën Tiranë –Durrës KM 4.8 Tiranë.

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2022 është 345 punonjës. (2021: 331 punonjës). Numri i punonjësve në fund të vitit 2022 i ndarë sipas kategorive është:

- 3 administrator
- 64 staf administrate
- 134 staf në prodhim
- 144 staf në marketing&shitje

## **2. Bazat e përgatitjes**

### **(a) Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

## **2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)**

### **(b) Baza e matjes**

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti për Interpretimet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("KIRFN") të BSNK-së.

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur në bazë të parimit të vijimësisë.

### **(c) Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto pasqyra financiare të konsoliduara janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

**(d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve**

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar kërkon që Drejtimi të bëjë gjykimet, vlerësimet dhe supozimet të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

**(e) Bazat e Konsolidimit**

Filialet janë të gjitha subjektet (duke përfshirë njësitë ekonomike për qëllime të veçanta) mbi të cilat Grupi ka fuqi për të qeverisur politikën financiare dhe operative, që në përgjithësi u atribuohen aksionerëve që zotërojnë më shumë se gjysmën e të drejtave të votës. Ekzistenca dhe efekti i të drejtave votuese potenciale që janë aktualisht të ushtrueshme ose të konvertueshme janë konsideruar kur është bërë vlerësimi nëse Grupi kontrollon një njësi tjetër ekonomike. Filialet janë konsoliduar plotësisht që nga data në të cilën kontrolli i është transferuar Grupit. Metoda e koston është përdorur për të kontabilizuar blerjen e filialeve nga Grupi. Kostoja e blerjes është matur në vlerën e drejtë të aktiveve të dhëna, instrumentave të kapitalit neto të emetuara dhe detyrimeve të pësuar ose konstatuara në datën e këmbimit, plus kostot direkte të blerjes. Aktivitetet e identifikueshme të blera dhe detyrimet e konstatuara në një kombinim biznesi njihen fillimisht me vlerën e drejtë në datën e blerjes, pavarësisht nga interesi i pakicës. Tejkalimi i koston së blerjes mbi vlerën e drejtë të pjesës të grupit të aktiveve neto të identifikueshme njihet si emri i mirë. Transaksionet midis shoqerive të grupit, balancat dhe fitimet e përealizuara për transaksione ndërmjet shoqerive të grupit janë eliminuar. Gjithashtu janë eliminuar humbjet e përealizuara. Politikën kontabël të filialeve janë ndryshuar kur ka qënë e nevojshme për t'u përputhur me politikën e miratuara nga Grupi.

**3. Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara****3.1. Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale**

Nga njoftimet kontabël e shpallura, për standardet që hyjnë në fuqi nga 1 janari 2022, nuk ka pasur ndryshime që të kenë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të njësisë ekonomike.

Standarde dhe ndryshime të tjera që janë efektive për herë të parë në 2022 dhe mund të zbatohen për njësinë ekonomike janë:

- Referenca në Kuadrin konceptual (Ndryshimet në SNRF 3)
- Koncesionet e qirasë të lidhura me Covid 19 përtej datës 30 qershor 2021 (Ndryshime në SNRF16)
- Aktivitet afatgjatë materiale, impiantet dhe pajisjet: të ardhurat përpara përdorimit të synuar (Ndryshimet në SNK 16)
- Kontratat me humbje - Kostoja e përbushjes së një kontrate (Ndryshimet në SNK 37)
- Përmirësimi vjetor (cikli 2018-2020)
- Filial si adoptues për herë të parë (Ndryshimet në SNRF 1)
- Tarifat në testin '10 përqind' për mosnjohjen e pasiveve financiare (Ndryshimet në SNRF 9)
- Tatimi në matjet e vlerës së drejtë (Ndryshimet në SNK 41).

Këto ndryshime nuk kanë një ndikim të rëndësishëm në këto Pasqyra Financiare dhe për këtë arsye nuk janë paraqitur.

**3.2. Standardet dhe interpretimet të lëshuara, por ende nuk janë adoptuar**

Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit ka publikuar një sërë standardesh dhe interpretimesh që janë efektive në periudhat e ardhshme kontabël, të cilat kompania ka vendosur të mos i zbatojë paraprakisht. Kompania planifikon të zbatojë këto standarde dhe interpretime kur ato të hyjnë në fuqi.

Standardet dhe interpretimet e mëposhtme janë lëshuar, por nuk janë të detyrueshme për periudhën aktuale të raportimit të përfunduar më 31 dhjetor 2022:



- Paraqitja e informacioneve shpjeguese të politikave kontabël (Ndryshimet në SNK 1 dhe Deklarata e Praktikës IFRS 2) - Në fuqi nga 1 janari 2023
- Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabël (Ndryshimet në SNK 8) - Në fuqi nga 1 janari 2023
- Tatimi i shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet që lindin nga një transaksion i vetëm (Ndryshimet në SNK 12) - në fuqi nga 1 janari 2023
- SNRF 17 – Kontratat e Sigurimeve – Në fuqi më 1 janar 2023

#### 4. Politika të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë aplikuar në të gjitha periudhat e pasqyruara në këto pasqyra financiare të konsoliduara dhe në mënyrë të vazhdueshme nga Shoqëria.

##### (a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e asaj date. Zërat jo monetare maten në bazë të kostos historike dhe nuk konvertohen në datën e raportimit.

Diferencat nga kursi i këmbimit nga zërat monetarë, njihen në fitim ose humbje të periudhës të cilës i përket. Fitimi dhe humbja nga monedha e huaj, raportohen në baza neto.

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
EUR/LEK	114.23	120.76
USD/LEK	107.05	106.54

##### (b) Instrumenta financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

##### Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përbëhen nga paraja në arkë, llogaritë rrjedhëse bankare dhe depozitat me afat maturimi më pak se tre muaj.

##### Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen.

**4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**(b) Instrumenta financiarë (vazhdim)**

*Llogaritë e pagueshme*

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera janë deklaruar me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

*Të tjera*

Të tjera instrumenta financiare jo derivative janë matur me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi.

*Huatë*

Huatë janë njohur fillimisht me vlerën e drejtë, neto nga kostot e transaksioneve dhe më pas njihen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, me shpenzime interesi të njohura bazuar në normën efektive. Metoda e interesit efektiv është metoda e llogaritjes të koston së amortizuar të detyrimit financiar dhe e alokimit të shpenzimit të interesit përgjatë periudhës përkatëse. Norma efektive e interesit është norma që skanton saktësisht vlerat e ardhshme të parave përgjatë jetëgjatësisë së planifikuar të detyrimit financiar ose, kur është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër vlerën e mbetur neto nga njohja fillestare.

**(c) Inventarët**

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

**(d) Aktive afatgjata materiale**

*Njohja dhe matja*

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë matur me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi i akumuluar.

Kostot përfshijnë shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivit. Kosto e aktivit të ndërtuar vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër direkte të lidhur me vënien e aktivit në kushtet e punës për përdorimin e parashikuar, kostot e çmontimit dhe heqjen e pjesëve dhe restaurimin e zonës në të cilat ato janë vendosur dhe kostot e huamarrjes së kapitalizuara. Programi i blerë që është pjesë përbërëse në funksionimin e një pajisjeje është kapitalizuar si pjesë e pajisjes.

**4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**(d) Aktive afatgjata materiale (vazhdim)**

Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato llogariten si zëra të ndara (pjesë të rëndësishme) të aktiveve afatgjata materiale.

*Kostot vijuese*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të pronave, makinerive dhe pajisjeve është njohur në vlerën kontabël (neto) të pjesës në qoftë se është e mundur që në të ardhmen të mirat ekonomike të përfshira në atë pjesë do t'i vijnë Shoqërisë dhe kostoja mund të matet me besueshmëri. Vlera kontabël (neto) e pjesës që zëvendësohet hiqet nga regjistrimet. Kostot e shërbimeve të përditshme të pronave, makinerive dhe pajisjeve janë të njohura në të ardhurat ose shpenzimet kur ndodhin.

*Amortizimi*

Amortizimi është llogaritur mbi vlerën e amortizueshme, e cila është kostoja e aktivitetit duke zbritur vlerën e mbetur. Amortizimi njihet me normat si më poshtë në bazë të vlerës së mbetur:

Ndërtesa	5%
Mobilje dhe orendi	20%
Mjetet e transportit	20%
Pajisje kompjuterike	25%
Makineri dhe pajisje	20%
Toka	0%

*Ç'regjistrimi*

Një zë i aktiveve afatgjata materiale ç'regjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e ndonjë zëri të aktiveve afatgjata materiale janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat e marra nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën kontabël (neto) të aktiveve afatgjata materiale dhe janë pasqyruar neto në të ardhura të tjera në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

**(e) Të ardhurat**

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

**4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)****(f) Qiratë**

Në datën e fillimit, njësi ekonomike mat detyrimin e qirasë me vlerën aktuale të pagesave të qirasë të papaguara në atë datë, e skontuar me normën shtesë të huamarrjes së njësisë ekonomike, pasi që kontratat e qirasë negocohen me palët e treta nuk është e mundur të përcaktohet norma e interesit që nënkuptohet në qira.

Norma rritëse e huamarrjes është norma e vlerësuar që njësi ekonomike duhet të paguajë për të marrë hua të njëjtën shumë gjatë një afati të ngjashëm, dhe me siguri të ngjashme për të marrë një aktiv me vlerë ekuivalente. Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë përbëhen nga pagesa fikse (përfshirë në substancë fikse), pagesa të ndryshueshme bazuar në një indeks ose normë, shuma që pritet të paguhet nën një garanci të vlerës së mbetur dhe pagesa që vijnë nga opsionet të cilat kanë një bazë të arsyeshme që do të ushtrohen.

Pas matjes fillestare, pasivi do të zvogëlohet nga pagesat e qirasë që shpërndahen midis ripagimeve të principalit dhe kostove financiare. Kostoja financiare është shuma që prodhon një normë konstante periodike interesi në pjesën e mbetur të detyrimit të qirasë.

Çdo fitim ose humbje në lidhje me përfundimin e pjesshëm ose të plotë të qirasë njihet në fitim ose humbje. Aktivi i së drejtës së përdorimit rregullohet për të gjitha modifikimet e tjera të qirasë.

Njësi ekonomike ka zgjedhur të regjistrojë qira afatshkurtra dhe qira të aktiveve me vlerë të ulët duke përdorur përshtatjet praktike. Në vend që të njohim një pasuri të së drejtës së përdorimit dhe detyrimin e qirasë, pagesat në lidhje me to njihen si një shpenzim në fitim ose humbje mbi një bazë lineare gjatë afatit të qirasë.

Norma e interesit të huamarrjes e aplikuar në detyrimet e qerasë është e barabartë me normën mesatare të interesit të publikuar nga Banka e Shqipërisë në muajin e fillimit të kontratës së qerasë.

**(g) Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit**

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

**(h) Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

**4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)****(i) Zhvlerësimi***(i) Aktivet financiare*

Një aktiv financiar jo i mbartur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes është vlerësuar në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë evidencë objektive për ta zhvlerësuar. Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidencë objektive që tregon se një ngjarje zhvlerësimi ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit dhe ka patur një ndikim negativ në rrjedhjen e ardhshme monetare të vlerësuar të aktivitetit financiar dhe këto efekte janë të matshme në mënyrë të besueshme.

Një humbje nga zhvlerësimi në lidhje me një aktiv financiar të matur me kosto të amortizuar është llogaritur si diferencë mes vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parasë të vlerësuar duke i skontuar me normën origjinale efektive të interesit të aktivitetit. Humbjet janë njohur në të ardhura dhe shpenzime dhe janë reflektuar në një llogari zbritje nga llogaritë e arkëtueshme. Interesi mbi një aktiv të zhvlerësuar vazhdon të njihet nëpërmjet skontimit të qëndrueshëm. Kur një ngjarje e ardhshme (p.sh. shlyerja e një debitori) shkakton një rënie në shumën e humbjes nga zhvlerësimi, rënia në humbjen nga zhvlerësimi rimerret nëpërmjet fitimit ose humbjes.

*(i) Aktive jo financiare*

Vlerat kontabël të aktiveve jofinanciare të Shoqërisë janë rishikuar në datën e raportimit për të përcaktuar në qoftë se ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Në qoftë se ndonjë tregues i tillë ekziston, atëherë llogaritet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Shuma e rikuperueshme është vlera më e lartë midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e vlerësuar monetare të ardhshme janë zbritur për vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike për aktivin për të cilat vlerësimet e flukseve monetare të ardhshme nuk janë rregulluar.

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në qoftë se vlera e mbartur e aktivitetit apo pjesa e burimit të parave e kalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në të ardhura ose shpenzime.

**(j) Provizionet**

Një provizion njihet në qoftë se, si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, Shoqërisë i lindin detyrime ligjore ose konstruktive të cilat mund të parashikohen me besueshmëri dhe është e mundur që të ndodhë një dalje e përfitimeve ekonomike për shlyerjen e detyrimit. Provizionet janë përcaktuar duke ju zbritur vlerën e pritshme të flukseve të parasë të skontuara me një normë para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike të detyrimeve. Skontimi i qëndrueshëm është njohur si kosto financiare.

**(k) Llogaritë e pagueshme dhe të shtyrat**

Detyrimet njihen për shumën të cilat duhet të paguhet në të ardhmen për të mirat dhe shërbimet e përfituara, qoftë të faturuara nga furnizuesi apo jo.

#### 4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

##### (l) Përfitimet e punëmarrësve

###### *Kontributet e detyrueshme shoqërore*

Një plan i kontributit të përcaktuar është një plan përfitimi pas periudhës së punësimit sipas të cilit një njësi ekonomike paguan kontribute në shuma fikse në një entitet të veçantë dhe nuk ka asnjë detyrim ligjor apo konstruktiv për të paguar shuma të mëtejshme. Qeveria e Shqipërisë është përgjegjëse për sigurimin e pensioneve në Shqipëri, sipas një plani të përcaktuar të kontributeve të pensionit. Kontributet e Shoqërisë në planin e përcaktuar të kontributeve të pensionit njihen si një shpenzim i përfitimit të punonjësve në të ardhura dhe shpenzime në periudhat gjatë të cilave kryhen shërbimet nga të punësuarit.

##### (m) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat për fondet e depozituara në bankë dhe fitimet nga kurset e këmbimit. Të ardhurat nga interesat njihen kur realizohen duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit, humbjet nga kurset e këmbimit dhe humbjet nga zhvlerësimi të njohura në aktivet financiare.

##### (n) Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përbëhet nga tatimi i periudhës dhe tatimi i shtyrë.

Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si edhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

##### (o) Angazhimet dhe kontigjencat

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare të konsoliduara, por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

##### (p) Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

## 5. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit

